



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Asdren Agushi B.I.

Emri Tregtar: NP "Radio Energji"

NUI: 810268385

Pronari: Asdren Agushi

OSHMA: Radio Shqip FM

Adresa: Rr/ Abdullahu Presheva, nr.63

Emri i Biznesit: "Klan Kosova" SH.P.K.

NUI: 810795297

Pronari: KGO Media Investments SH.P.K.


NUI: 811575804

Pronari: KGO Media Investments DOOEL

EMBS: 711532 (Shkup)

Pronari: Kushtrim Gojani

Adresa: Rr/ Zona Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve Prishtinë



VENDIM

për refuzimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës të Radio Shqip FM, me seli në Komunën e Gjilanit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Shqip FM është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga KPM, për transmetim tokësorë të programeve të radios, me seli në komunën e Gjilanit. KPM, me datën 6 tetor 2009 i ka lëshuar licencën afatgjatë Radio Shqip FM, ndërsa në datën 6 tetor 2016, ka bërë ripërtëritjen e licencës së për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 21 dhjetor 2021, Radio Shqip FM ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Shqip FM nga biznesi individual Asdren Agushi B.I, me emër tregtar NP "Radio Energji", me Numër Unik Identifikues (NUI) 810268385 dhe me pronar z. Asdren Agushi tek biznesi Klan Kosova SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 810795297, me pronar personin juridik KGO Media Investments SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI), ndërsa ky biznes me pronar personin juridik KGO Media Investments DOOEL EMBS: 711532 (Shkup) dhe me personin fizik si pronar z. Kushtrim Gojani.
4. Gjithashtu, me të njëjtën kërkesë është kërkuar edhe aprovimin i KPM-së për ndryshimin e skemës programore si dhe ndryshimin e emrit nga Radio Shqip FM në Radio Klan Kosova FM.

5. Për shkak të mungesës së kuorumit të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e Radio Shqip FM nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

Arsyetim

6. Në bazë të neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së, lidhur me ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e një licence nga një person fizik apo juridik tek një person tjetër fizik apo juridik përcaktohet së:

“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.

7. Për më tepër, neni 15, paragrafi 4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që:

“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”

8. Komisioni në takimin e datës 17 korrik 2023, ka shqyrtuar kërkesën për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Shqip FM nga biznesi individual Asdren Agushi B.I, me emër tregtar NP “Radio Energji”, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810268385 dhe me pronar z. Asdren Agushi tek biznesi Klan Kosova SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 810795297, me pronar personin juridik KGO Media Investments SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI), ndërsa ky biznes me pronar personin juridik KGO Media Investments DOOEL EMBS: 711532 (Shkup) dhe me personin fizik si pronar z. Kushtrim Gojani si dhe kërkesën për ndryshim të skemës programore dhe emrit të Radio Shqip FM.
9. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë, pronari aktual i Radio Shqip FM ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim janë vështirësitë financiare të shkaktuara nga situata me pandeminë Covid -19, për arsye se me fillimin e pandemisë bizneset i kanë ndaluar reklamat.
10. Komisioni konstaton se kërkesa për ndryshim të pronësisë përmban certifikatën e regjistrimit të biznesit Klan Kosova Sh.p.k. e cila është pezulluar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me vendimin e datës 14 qershor 2023, dhe gjithashtu përmban informacione lidhur adresën e pronarit si person fizik të cilat vlerësohet se janë në kundërshtim me integritetin territorial të Republikës së Kosovës të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
11. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se kërkesa e Radio Shqip FM për kalimin e pronësisë tek Klan Kosova Sh.p.k. nuk është në pajtim me politikat e transmetimit të KPM-së, konkretisht me neni 9, paragrafi 6, i Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili përcakton se:

